



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Publikim Teknik – TP 02

Certifikimi i Aerodromeve

Manual Udhëzues

Parathënie

Qëllimi i këtij manuali është që ta përshkuaj procesin e certifikimit dhe të jep udhëzim për ata që aplikojnë për Certifikatë Aerodromi.

Në mënyrë që sistemi të ketë një kontribut real në sigurinë e fluturimit të aviacionit civil të Republikës së Kosovës, është e nevojshme që të gjithë aplikantët që aplikojnë për Certifikatë Aerodromi të janë në përputhje me Ligjin e Kosovës për Aviacionin Civil, Rregulloren 1/2008 mbi Aerodromet, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 4/2012 dhe procedurat e përshkruara në këtë manual.

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm
Autoriteti i Aviacionit Civil

Lista e faqeve efektive

Kaptiulli	Faqe	Nr. i rishikimit	Data efektive
Parathënie	1 nga 44	Verzioni 3	23.03.2016
Lista e faqeve efektive	2 nga 44		
	3 nga 44		
	4 nga 44		
Lista e shpërndarjes Tabela e Rishikimit	5 nga 44		
Përmbajtja	6 nga 44		
	7 nga 44		
Termet dhe përkufizimet	8 nga 44		
	9 nga 44		
	10 nga 44		
	11 nga 44		
	12 nga 44		
KAPITULLI 1: Të përgjithshme	13 nga 44		
1.1 Qëllimi i udhëzuesit			
1.2 Përdorimi i Manualit	14 nga 44		
1.3 Përgjegjësitë e përgjithshme			
1.4 Përgjegjësitë e certifikimit	15 nga 44		
	16 nga 44		
	17 nga 44		
KAPITULLI 2: Procedurat e certifikimit të aerodromeve	18 nga 44		
2.1 Zbatueshmëria			
2.2 Aplikimi për një certifikatë aerodromi	19 nga 44		
2.3 Vlerësimi i aplikacionit			
2.4 Inspektimet dhe auditimet e aerodromit	20 nga 44		
2.5 Dhënia e certifikates së aerodromit	21 nga 44		
2.6 Llojet e certifikatës së aerodromit			
2.7 Ndryshimi i certifikates së aerodromit	22 nga 44		
2.8 Kushtet për certifikatë aerodromi			
2.9 Tarifa e certifikatës			
2.10 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e certifikatës			
2.11 Pagesat ne aerodrom të certifikuar			
2.12 Përrjashtimet	23 nga 44		
KAPITULLI 3: Kërkesat e certifikimit	24 nga 44		

3.1 Kërkesat e planit të aerodromit			
3.2 Kufizimet e aerodromit			
3.3 Kërkesat e personelit			
3.4 Plani emergjent i aerodromit	25 nga 44		
3.5 Shërbimet e shpëtimit dhe zjarrfikjes	26 nga 44		
	27 nga 44		
	28 nga 44		
3.6 Mbrojtja publike	29 nga 44		
3.7 Menaxhimi i rezikshmërisë nga shtazët			
3.8 Garantimi i sigurisë së brendshme të aerodromit			
3.9 Manuali i Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit	30 nga 44		
	31 nga 44		
	32 nga 44		
	33 nga 44		
KAPITULLI 4: Kërkesat operuese	34 nga 44		
4.1 Pajtueshmëria e vazhdueshme			
4.2 Mirëmbajtja e aerodromit			
4.3 Ndriçimi për navigacion /mirëmbajtje /kontroll			
4.4 Punët në aerodrom			
4.5 Plani emergjent i aerodromit	35 nga 44		
4.6 Kërkesat operuese të shpëtimit dhe zjarrfikjes			
4.7 Menaxhimi i trafikut ajror të aerodromit	36 nga 44		
4.8 Shërbimi i menaxhimit të platformës	37 nga 44		
4.9 Plani i inspektimit të aerodromit			
4.10 Automjetet e terrenit			
4.11 Mbrojtja e mjeteve të navigimit	38 nga 44		
4.12 Njoftimi për kushtet e aerodromit			
4.13 Kushtet e mospërputhjes			
4.14 Ndryshimet në organizimin e mbajtësit të certifikatës	39 nga 44		
KAPITULLI 5: Sigurimi i aerodromeve	40 nga 44		
5.1 Zbatueshmëria	41 nga 44		
5.2 Kërkesat për sigurim në aerodrome	42 nga 44		
KAPITULLI 6: Përgjegjësitë dhe struktura e lartë organizative e aerodromit	43 nga 44		
6.1 Menaxheri Përgjegjës			
6.2 Menaxheri për Siguri			
6.3 Menaxheri për Operim	44 nga 44		
6.4 Pozicionet tjera lidhur me sigurinë			

	Emri dhe pozita	Data	Nënshkrimi
Ndryshimet e përgatitura nga:	Emir Hiseni, Inspektor, Departamenti i Aerodromeve	11.03.2016	E nënshkruar në versionin e gjuhës angleze
Autorizuar nga:	Burim Dinarama, Drejtor, Departamenti i Aerodromeve	21.03.2016	
Kontrolli i cilësisë:	Lendita Kika-Berisha, Menaxher i Cilësisë dhe Sigurisë	22.03.2016	
Aprovuar nga:	Dritan Gjonbalaj, Drejtor i Përgjithshëm	23.03.2016	

Lista e shpërndarjes

Nr. i kopjes	Vendndodhja	Media	Sasia
1	Biblioteka e AAC-së	Origjinal + Digjital	1
2	Serveri i AAC-së	Digjital	1

Tabela e Rishikimit

Nr. Rish	Data	Përgatitur nga:	Autorizuar nga:

Përmbajtja

Parathënie.....	1
Lista e faqeve efektive	2
Lista e shpërndarjes	5
Tabela e Rishikimit	5
Përmbajtja.....	6
Termet dhe përkufizimet	8
KAPITULLI 1: Të përgjithshme	13
1.1 Qëllimi i udhëzuesit.....	13
1.2 Përdorimi i Manualit.....	14
1.3 Përgjegjësitë e përgjithshme	14
1.4 Përgjegjësitë e certifikimit	15
KAPITULLI 2: Procedurat e certifikimit të aerodromeve	18
2.1 Zbatueshmëria	18
2.2 Aplikimi për një certifikatë aerodromi.....	19
2.3 Vlerësimi i aplikacionit.....	19
2.4 Inspektimet dhe auditimet e aerodromit	20
2.5 Dhënia e certifikates së aerodromit	21
2.6 Llojet e certifikatës së aerodromit	21
2.7 Ndryshimi i certifikates së aerodromit	22
2.8 Kushtet për certifikatë aerodromi.....	22
2.9 Tarifa e certifikatës	22
2.10 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e certifikatës	22
2.11 Pagesat ne aerodrom të certifikuar	22
2.12 Përrjashtimet.....	22
KAPITULLI 3: Kërkesat e certifikimit.....	24
3.1 Kërkesat e planit të aerodromit.....	24
3.2 Kufizimet e aerodromit	24
3.3 Kërkesat e personelit.....	24
3.4 Plani emergjent i aerodromit	25
3.5 Shërbimet e shpëtimit dhe zjarrfikjes	26

3.6	Mbrojtja publike	29
3.7	Menaxhimi i rezikshmërisë nga shtazët.....	29
3.8	Garantimi i sigurisë së brendshme të aerodromit	29
3.9	Manuali i Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit	30
KAPITULLI 4: Kërkesat operuese		34
4.1	Pajtueshmëria e vazhdueshme	34
4.2	Mirëmbajtja e aerodromit.....	34
4.3	Ndriçimi për navigacion/mirëmbajtje/kontroll	34
4.4	Punët në aerodrom.....	34
4.5	Plani emergjent i aerodromit	35
4.6	Kërkesat operuese të shpëtimit dhe zjarrfikjes	35
4.7	Menaxhimi i trafikut ajror të aerodromit.....	36
4.8	Shërbimi i menaxhimit të platformës	37
4.9	Plani i inspektimit të aerodromit	37
4.10	Automjetet e terrenit.....	37
4.11	Mbrojtja e mjeteve të navigimit.....	38
4.12	Njoftimi për kushtet e aerodromit	38
4.13	Kushtet e mospërputhjes.....	38
4.14	Ndryshimet në organizimin e mbajtësit të certifikatës.....	38
KAPITULLI 5: Sigurimi i aerodromeve.....		40
5.1	Zbatueshmëria	40
5.2	Kërkesat për sigurim në aerodrome	40
KAPITULLI 6: Përgjegjësitë dhe struktura e lartë organizative e aerodromit.....		43
6.1	Menaxheri Përgjegjës	43
6.2	Menaxheri për Siguri	43
6.3	Menaxheri për Operim	44
6.4	Pozicionet tjera lidhur me sigurinë.....	44

Termit dhe përkufizimet

Në këtë manual, termit e përdorur janë në përputhje me ato në Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, Rregullores 1/2008 për Aerodromet, ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 4/2012 dhe versionit të fundit të Aneksit 14 të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar. Megjithatë disa nga termit e përdorur më shpesh, janë dhënë më poshtë për referim më të lehtë për përdoruesin:

Termi	Përkufizimi
Aerodrom	Aerodrom nënkupton zonën e përcaktuar në tokë apo ujë (duke i përfshirë të gjitha objektet, instalimet dhe pajisjet) që parashihet apo planifikohet të përdoret plotësisht apo pjesërisht për ardhje, shkuarje dhe lëvizje të avionëve nëpër sipërfaqe.
Aerodrom ndërkombëtar	Aerodrom ndërkombëtar do të thotë secili aerodrom i përcaktuar si një aerodrom për hyrje dhe dalje të trafikut ajror ndërkombëtar ku kryhen formalitetet e doganës, imigrimit, shëndetësisë publike, karantinës së shtazëve dhe bimëve dhe procedurave të tjera.
Aerodrom vendor	Aerodrom vendor nënkupton çdo aerodrom përveç ndryshe të përcaktuar si aerodrome ndërkombëtare.
Aerodrom i Certifikuar	Një aerodrom të cilit operator iu është lëshuar një certifikatë aerodromi.
Aplikues	Aplikues do të thotë secili person apo entitet ligjor i cili ka dorëzuar një aplikacion për një certifikatë aerodromi
Autoriteti	Në këtë manual, Autoriteti nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës.
Avion	Avion do të thotë secila makinë e cila përfiton mbështetje në atmosferë nga reaksionet e ajrit, ose ndryshe nga reaksionet e ajrit kundrejt sipërfaqes së tokës.
Brezi anësore	Zonë e ngjitur në skaj të rrugës së shtruar e përgatitur në atë mënyrë që të sigurojë një kalim në mes të rrugës së shtruar dhe sipërfaqes së ngjitur.
Brezi anësor i shtigjeve	Një zonë ku përfshihet shtegu i taksimit që ka për

për taksim	qëllim të mbroj një avion që operon në shteg të taksimit dhe që të zvogëlojë rrezikun e dëmtimit të një avioni i cili aksidentalisht del jashtë shtegut të taksimit.
Certifikata e Aerodromit	Certifikata e Aerodromit nënkupton një certifikatë të lëshuar nga Autoriteti në përputhshmëri me dispozitat e certifikimit sipas Rregulloreve aktuale të Aviacionit Civil.
Faktori i përdorshmërisë	Përqindja e kohës gjatë së cilës përdorimi i pistës apo sistemit të pistës nuk është i limituar për shkak të erës tërthore.
Heliport	Nënkupton një aerodrom apo zonë të caktuar në një vend, e menduar për t'u përdorur plotësisht apo pjesërisht për ardhje, shkuarje dhe lëvizje të helikopterëve në sipërfaqe
Inspektor i Aerodromit	Inspektor i Aerodromit nënkupton çdo person të autorizuar nga ana e Autoritetit për të inspektuar një aerodrom.
Instrument i pistës	Një pistë e parashikuar për operime të avionëve duke përdorur procedura me qasje instrumentale të afrimit.
Maksimumi i kapacitetit ulës të pasagjerëve	Në lidhje me një avion, do të thotë maksimumi i numrit të ulëseve për pasagjerë, lejuar nën llojin e miratuar të certifikatës së avionëve.
Maksimumi i peshës mbajtëse	Në lidhje me një avion, do të thotë maksimumi i kapacitetit ulës të pasagjerëve apo maksimumi i ngarkesës me pagesë, lejuar nën llojin e miratuar të certifikatës së avionëve.
Manuali i Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromeve	Manuali i cili është pjesë e aplikacionit për certifikatë aerodromi në pajtim me kërkesat e Manualit për Certifikim të Aerodromeve duke përfshirë secilin ndryshim të cilin e ka pranuar Autoriteti.
Objektet dhe pajisjet e Aerodromit	Objektet dhe pajisjet brenda ose jashtë vijës kufizuese të aerodromit e që janë të ndërtuara apo të instaluar dhe që mirëmbahen për ardhje, shkuarje dhe lëvizje të avionëve nëpër sipërfaqe.

Operator i Aerodromit	Secili person apo entitet ligjor i autorizuar nga ana e Autoritetit për të drejtuar dhe operuar një aerodrom përmes lëshimit të një certifikate të aerodromit.
Pengesë	Të gjitha objektet e fiksuara (qoftë të përkohshme apo të përhershme) apo mobile apo pjesët e tyre, të cilat ndodhen në një zonë të paraparë për lëvizje sipërfaqësore të avionit apo që zgjaten mbi kufirin e një sipërfaqeje të përcaktuar që është paraparë të mbrojtë avionin në fluturim.
Person i Autorizuar	Në këtë manual, "I Autorizuar" do të thotë një person i autorizuar nga Autoriteti.
Pista	Një vend i caktuar në tokë të aerodromit përgatitur për aterrim dhe ngritje të avionit.
Pistë pa instrumente	Një pistë e përcaktuar për operim të avionit duke përdorur procedurat vizuale të afrimit.
Platformë	Një vend i caktuar në tokën e aerodromit, që ka për qëllim akomodimin e aeroplanëve për qëllime të hipjes apo zbritjes së pasagjerëve, ngarkimit e shkarkimit të postës apo mallit, mbushjes me derivate, parking apo mirëmbajtje.
Pragu	Fillimi i asaj pjese të pistës që është e përdorshme për aterrim. Pragu i cili nuk gjendet në skaj të pistës njihet si prag i zhvendosur.
Prishje e dritës	Një dritë/llambë konsiderohet të jetë e prishur atëherë kur për çfarëdo arsye intensiteti mesatar i përcaktuar për të përdorur këndet e veçuara të ngritjes së krahëve, në pjesë të përparme dhe të përhapur, bie nën 50 për qind të intensitetit mesatar të veçuar të një drite të re.
Shenja	Një simbol apo një grup simbolesh të paraqitura në sipërfaqen e zonës së lëvizjes për të ofruar informata aeronautike
Shënjeshti	Një objekt që është mbi nivelin e tokës e që tregon ndonjë pengesë apo që paraqet një kufi.
Shërbimi i menaxhimit	Shërbimi i Menaxhimit të Platformës do të thotë një

të platformës	shërbim i dhënë për të rregulluar aktivitetet dhe lëvizjet e avionëve dhe automjeteve në një platformë.
Shërbimi i Trafikut Ajror	Shërbimi i trafikut ajror përfshin (a) shërbimin e kontrollit të aerodromit; (b) shërbimin kontrollimit të afrimit; (c) shërbimin e kontrollit zonal; (d) shërbimin informativ të fluturimit; (e) shërbimin alarmues dhe (f) çdo shërbim tjetër i trafikut ajror që nga ana e Autoritetit konsiderohet të jetë i nevojshëm apo i dëshirueshëm për operim të sigurve dhe efikas të sistemit të aviacionit civil.
Shtegu i taksimit	Një shteg i përcaktuar në tokën e aerodromit i krijuar për taksim të avionëve, dhe i paraparë që të krijojë një lidhje në mes të njërës dhe pjesës tjetër të aerodromit duke përfshirë pozitat e parkimit të avionëve, rrugës së taksimit, platformës, shtegut për taksim, dhe daljes së shpejtë nga shtegu i taksimit.
Shtegu i pistës	Një vend i caktuar duke përfshirë pistën dhe vendin e ndaljes, nëse ekziston, e që synon të (a) zvogëlojë rrezikun e dëmtimit të avionit që ngrihet nga pista dhe (b) të mbrojë avionin që fluturon mbi të gjatë ngritjes apo operimeve të aterimit.
Sipërfaqet për kufizim të pengesave	Një seri sipërfaqesh që përcaktojnë madhësinë e hapësirës ajrore në dhe përreth aerodromit, e që duhet të mbahet e lirë nga pengesat në mënyrë që të lejojë që operimet e aerodromit të kryhen sigurt dhe që të parandalojë aerodromin të jetë i pashfrytëzueshëm nga rritja e pengesave përreth aerodromit.
Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë	Një sistem për menaxhim të sigurisë nëpër aerodrome duke përfshirë strukturën organizative, përgjegjësitë, procedurat, proceset dhe dispozitat për zbatim të politikave të menaxhimit të sigurisë nga operatori i aerodromit, i cili ofron kontroll të sigurisë, dhe shfrytëzim të sigurt të aerodromit.
Vend-punim	Një pjesë e aerodromit ku punët e mirëmbajtjes apo ato të ndërtimit janë në zhvillim e sipër.
Zonë aterrimi	Ajo pjesë e zonës së lëvizjes e parashikuar për aterrim dhe ngritje të avionëve.

Zonë e lëvizjes	Ajo pjesë e një aerodromi që do të shfrytëzohet për ngritje, aterrim dhe taksim të avionëve, e që përbëhet prej zonës së manovrimit dhe platformës(ave).
Zonë e Lirë nga Pengesat (ZLP)	Hapësira ajrore mbi sipërfaqen e brendshme të sipërfaqes, sipërfaqet e brendshme transite dhe sipërfaqen e aterrimit me ndërprerje si dhe ajo pjesë e brezit e ngjitur me këto sipërfaqe, në të cilën nuk depërton asnjë pengesë e fiksuar përveç atyre me një masë të vogël dhe me montim të brishtë që kërkohet për nevojat e navigacionit ajror.
Zonë e ndaljes	Një zonë e përcaktuar drejtkëndore në tokë në fund të sipërfaqes ne dispozicion për ngritje, përgatitur si një zonë e përshtatshme në të cilën një avion mund të ndalët në raste të ndonjë ngritjeje të braktisur.
Zonë e papërdorshme	Një pjesë e zonës së lëvizjes që është e papërshtatshme dhe e pa-përdorshme për t'u shfrytëzuar nga avioni
Zonë manovrimi	Ajo pjesë e një aerodromi që do të përdoret për ngritje, aterrim dhe taksim të avionëve, duke përjashtuar platformat.
Zonë pa Pengesa	Një zonë e përcaktuar drejtkëndore ne toke apo në ujë që është nën kontroll të operatorit te aerodromit e zgjedhur apo e përgatitur si një zonë e përshtatshme mbi të cilën një avion mund të bëjë një ngritje fillestare deri në një lartësi të caktuar.

KAPITULLI 1: Të përgjithshme

1.1 Qëllimi i udhëzuesit

1.1.1 Siguria e Aerodromit është thelbësore për sigurinë e aviacionit. Kjo arrihet duke siguruar pajisje për aerodromin dhe duke mirëmbajtur mjediset që janë të sigurta për operim të avionëve. Në përputhje me standardet dhe procedurat e përshkruara dhe marrjen e një qasje pro-aktive të menaxhimit të sigurisë në operimet e aerodromit, operatorët e aerodromit mund të tregojnë se kanë kryer detyrimet e tyre të sigurisë për publikun që udhëton.

1.1.2 Ky dokument, i titulluar: "Manual për Certifikim të Aerodromeve" është përgatitur në bazë të Ligjit nr 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe Rregullores 1/2008 për Aerodromet, ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 4/2012. Dokumenti përcakton regjimin rregullativ të aerodromeve për t'u përdorur nga avionët që kryejnë operime të transportit ajror. Regjimi rregullativ kërkon që aerodromet të jenë të certifikuar. Prandaj, dokumenti përcakton standardet dhe procedurat operative për aerodromet e certifikuar që përdoren për operimet e transportit ajror

1.1.3 Qëllimi i këtij manuali është që të jep udhëzim tek aplikuesit dhe operatorët e aerodromit, si në vijim: -

- (a) mjedisin e aviacionit civil në Kosovë;
- (b) procedurat e certifikimit të aerodromit;
- (c) kërkesat për certifikim të aerodromit,
- (d) kërkesat për operim të aerodromit; dhe
- (e) kërkesat për sigurim dhe shfrytëzim të aerodromit.

1.1.4 Standardet e Aerodromeve do të ndryshojnë herë pas here për të përmbushur nevojat e identifikuar të sigurisë, ndryshimet në teknologji dhe ndryshimet në standardet dhe praktikat ndërkombëtare. Nevoja për të ndryshuar këtë dokument kohë pas kohe mund të bëhet për shumë arsye.

Këto mund të jenë për të:

- (a) garantuar siguri;
- (b) garantuar standardizim;
- (c) reagoj në ndryshimet e standardeve të aerodromeve që dalin nga e Ligjet Komunitare (Acquis Communautaire);
- (d) reagoj në ndryshimet e Standardeve ONAC-it dhe Praktikave të Rekomanduara; apo
- (e) përshtat iniciativa apo teknologji të reja.

1.1.5 Kërkesat në këtë manual duhet të lexohen së bashku me këto si në vijim:

- (a) Aneksi 4 i ONAC-it: Skicat Aeronautike

- (b) Aneksi 14 i ONAC-it: Aerodromet
- (c) Dok. 9157/AN901 i ONAC-it: Manuali i Dizajnit të Aerodromit (të gjitha pjesët)
- (d) Dok. 9137 i ONAC-it Manuali i Shërbimeve të Aerodromit (të gjitha pjesët)
- (e) Dok. 9774 i ONAC-it Manuali për Certifikim të Aerodromeve

1.1.6 Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës, ka ndërmend të botoj qarkoret këshilluese të cilat do të përmbajnë informacione në lidhje me standardet, praktikat dhe procedurat të cilat Autoriteti i ka paraparë të jenë të pranueshme në pëlqim me rregullat e ndërlidhura të këtij manuali. Megjithatë, përderisa këto qarkore këshilluese të jenë të botuara dhe zbatuara, standardet, praktikat dhe procedurat e përshkruara në manualët përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil do të jenë të zbatueshme.

1.2 Përdorimi i Manualit

1.2.1 Manuali është i përshtatshëm për t'u përdorur dhe është i organizuar në atë mënyrë që të mbulojë kryesisht kërkesat dhe procedurat që duhet të plotësohen nga aplikuesi apo operatori i aerodromit i cili dëshiron të pajiset me një certifikatë aerodromi

1.2.3 Manuali është i organizuar në kapituj të ndryshëm që të ndihmojë në qasje të lehtë për përdoruesit. Janë gjashtë kapituj që diskutojnë për mjedisin e aviacionit civil në Kosovë dhe për përgjegjësitë e autoritetit/operatorit, procedurat e certifikimit të Aerodromit, kërkesat e certifikimit të Aerodromit, kërkesat operative të Aerodromit, Sigurimin e Aerodromit, strukturën e lartë organizative dhe përgjegjësitë dhe shtojcën me formularin e aplikimit për certifikim.

1.3.4 Kohë pas kohe Autoriteti do të apo mund të plotësojë udhëzuesin apo kërkesat e dhëna në këtë manual.

1.3 Përgjegjësitë e përgjithshme

1.3.1 Autoriteti i Aviacionit Civil

Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, i referuar në këtë manual si Autoriteti ose AAC, është përgjegjës për funksionet rregulluese dhe mbikëqyrëse në Kosovë të cilat përfshijnë:

- (a) Ofruesit e Shërbimeve të Navigimit Ajror;
- (b) Rregullimin e operimeve të fluturimit;
- (c) Vlefshmërinë ajrore të avionëve;
- (d) Licencimin e personelit;
- (e) Certifikimin e aerodromeve; dhe

- (f) Rregullimin ekonomik të aerodromeve dhe të ofruesve të shërbimeve të navigimit ajror.

1.4 Përgjegjësitë e certifikimit

1.4.1 Përgjegjësitë e Autoritetit rreth certifikimit

Ligji nr 03/L-051 për Aviacionin Civil Pjesa 3 dhe Rregullorja 1/2008 për Aerodromet theksojnë se Autoriteti do të jetë përgjegjës për certifikimin e Aerodromeve në Kosovë. Autoriteti duhet të sigurojë certifikimin dhe vazhdueshmërinë e mbikëqyrjes së aerodromeve në Kosovë. Do të kryej detyra të tilla si:

- (a) vlerësimin e aplikacionit për certifikim të aerodromit; dhe
- (b) sigurimin e mirëmbajtjes së standardeve të veçuara dhe praktikave të rekomanduara për objekte të ndryshme në aerodrom të certifikuar, përmes vëzhgimeve, inspektimeve dhe auditimeve.

1.4.2 Përgjegjësitë e certifikimit të një Operatori të Aerodromit

Operatori i aerodromit do të jetë përgjegjës për drejtim të sigurve, efikas dhe të rregullt të operimeve të avionëve në një aerodrom të certifikuar. Operatori gjithashtu do të jetë përgjegjës për pajtueshmërinë me të gjitha rregulloret dhe udhëzimet, që janë shtesë e dispozitave dhe kushteve të certifikatës, të cilat Autoriteti mund ti shpall dhe ti jep. Operatori i aerodromit do të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Manualit të Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit sipas Rregullores 1 / 2008 për Aerodromet

Detaje të ndryshme të përgjegjësisë funksionale që duhet të përbëjnë pjesë të Manualit të Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit, janë dhënë më poshtë -

1.4.2.1 Përgjegjësitë funksionale të Operatorit të Aerodromit:

- (a) Inspektim gjithëpërfshirës dhe rutinor të sipërfaqes së zonës së manovrimit përfshirë zonat e ngjitura të pashtuara, rrethojat etj dhe dorëzimin e raporteve në kontrollin e trafikut ajror; mirëmbajtjen e zonave të inspektuara, dhe nevoja për pastrim, ngjyrosje, shënjim, prerje të barit dhe mirëmbajtje të 5 sipërfaqes;
- (b) Inspektim gjithëpërfshirës dhe rutinor të ndriçimit, bllokimit dhe ndriçimit të platformës, dhe dorëzimin e raporteve në kontrollin e trafikut ajror, mirëmbajtjen dhe funksionimin e ndonjë drite/llambe të prishur, dëmtimit të pistës, pajisjeve të thyera dhe pa-radhitura dhe prishjeve të tjera

- (c) kontrolli i rrezikshmërisë nga zogjtë, kontrolli i rrezikshmërisë nga shtazët dhe masat për shpërndarjen e tyre;
- (d) matja e koeficientit fërkues në pistë, shtigje të taksimit etj: dhe
- (e) Ndihma në kontrollin e trafikut ajror në shpërndarjen e vendqëndrimeve të avionëve në kontrollin e lëvizjeve të automjeteve / personave në zonat e lëvizjes
- (f) kryerjen e riparimeve mirëmbajtëse të sipërfaqeve të aeroportit siç janë zonat e shtruara, zonat me bar, dëmtimi, zorrët (tubat) e zjarrit, rrethojat e kufirit, ngjyrosja e shenjave etj përfshirë edhe objektet e terminalit
- (g) mirëmbajtjen e ndriçimit të aerodromeve, që lidhen me shenjat udhëzuese, sistemin udhëzues të platformës, bllokimin e ndriçimit, ndriçimin e platformës, ndriçimin e përgjithshëm dhe sistemin mbështetës të furnizimit me energji duke përfshirë mirëmbajtjen e të gjitha shërbimeve të tilla të tjera që kërkohen për operim të sigurve dhe të efektshëm të avionëve në aerodrom;
- (h) bën sigurimin për shërbimet thelbësore që ofrohen për agjencitë tjera që punojnë në aerodrom siç janë Policia, Doganat, Meteorologjia, Shëndetësia, Imigrimi, Agjencitë e Linjave Ajrore dhe të Karburantit etj
- (i) themelimin e një qendre koordinuese të kontrollit që të pranojë dhe shpërndajë informacione lidhur me operimet e një aerodromi. Qendra e Kontrollit duhet të jetë e pajisur me mjete të përshtatshme të komunikimit për të komunikuar me agjencitë tjera operative, siç janë ATC, MET, RFFS, AIS, Policia dhe Linjat Ajrore
- (j) themelimin e një sistemi për njoftim të menjëhershëm mbi ndryshimet në statusin e objekteve të rëndësishme që ndikojnë në operimet e aerodromeve, gjatë gjithë orëve të publikuara të operimeve të aerodromit dhe të përcjellë të njëjtat tek AIS për veprime të NOTAM-it
- (k) themelimin e një sistemi për leje pune për kontrollimin e punëve të ndërimit dhe të mirëmbajtjes në zonën operative
- (l) themelimin e shërbimeve mjekësore dhe trajtuese (mbështetëse) për pasagjerët tjerë në aerodrom në përputhje me standardet dhe praktikat e rekomanduara në fuqi.

1.4.2.2 Përgjegjësitë Funktionale të Shërbimeve të Shpëtimit dhe Zjarrfikjes

- (a) që kanë të bëjnë me të gjitha emergjencat, zjarret dhe incidentet e ndërlidhura në aerodrom;
- (b) mirëmbajtjen e një koordinimi efektiv me kontrollin e trafikut ajror, departamentit lokal të zjarrfikjes, ambulancës, policisë dhe agjencive të tjera që japin ndihmë në lidhje me operimet shpëtimit dhe zjarrfikjes së avionëve;
- (c) detyra të tjera sipas nevojës të cilat nuk ndërhyjnë me detyrat kryesore në plotësimin e kohës së duhur të reagimit dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të shpëtimit dhe zjarrfikjes në kategoritë e përshkruara të aerodromit;
- (d) detyrat në parandalimin e zjarrit, në të dy aspektet atë të planifikimit dhe të praktikës, trajnime të rregullta për të rritur efikasitetin e sistemit, si dhe trajnimi i personelit jo-shpëtues dhe zjarrfikës në detyrat e parandalimit të zjarrit.

KAPITULLI 2: Procedurat e certifikimit të aerodromeve

2.1 Zbatueshmëria

2.1.1 Neni 5 i Rregullores 1/2008 për Aerodromet përshkruan se një aplikues mund të aplikojë tek Autoriteti për një certifikatë aerodromi që e autorizon aplikuesin të operojë me një aerodrom në një vend siç është cekur në aplikacion.

2.1.1.1 Me pranimin e aplikacionit, Autoriteti duhet të merr në konsideratë:

- i. sjelljen dhe përvojën e mëhershme të aplikuesit;
- ii. pajisjet, organizatën dhe personelin e tij;
- iii. rregullimet të cilat ai propozon ti bëjë për të siguruar që aerodromi është duke u mirëmbajtur në mënyrë të përshtatshme dhe të sigurt për shfrytëzim nga avionët; dhe
- iv. karakteristikat fizike të aerodromit dhe rrethinës së saj;

Nëse Autoriteti konstaton se aplikuesi është kompetent dhe aerodromi është i sigurt për t'u shfrytëzuar nga avionët, Autoriteti do t'i japë certifikatë duke iu nënshtruar kushteve të tilla për të cilat Autoriteti mendon ti vendosë

2.1.1.2 Sipas Rregullores 1/2008 për Aerodromet një certifikatë do jetë në fuqi për një periudhë prej 5 viteve, siç edhe specifikohet në certifikatë dhe e njëjta mund të përtërihet për periudhë të njëjtë nëse Autoriteti konsideron se përshtatet.

2.1.1.3 Drejtori Gjeneral mundet, sipas kësaj rregulloreje të lëshojë një certifikatë për çfarëdo aerodromi i cili shërben për operacione të transportit ajror dhe mund ti parashtroje kushte aerodromit sipas nevojës në rrethana të veçanta.

2.1.1.4 Sipas kësaj rregulloreje në lidhje me një aerodrom, kur lëshohet një certifikatë për operacionet e transportit ajror, aerodromi do të vihet në dispozicion, në çdo kohë kur është i gatshëm për ngritje dhe aterrim të avionëve, për të gjithë shfrytëzuesit në norma dhe kushte të barabarta.

2.1.1.6 Asnjë person nuk mund të operoj me një aerodrom të certifikuar në Republikën e Kosovës, përveç nëse-

- (a) ai mban një certifikatë për këtë gjë; dhe
- (b) Ai operon me aerodromin në përputhje me termat dhe kushtet e certifikatës

2.1.2 Procedurat e miratuara nga Autoriteti për lëshimin e një certifikate aerodromi normalisht duhet të jenë në renditje si në vijim:

- (a) Pranimi i aplikacionit;

- (b) Vlerësimi i aplikacionit nga Autoriteti;
- (c) Inspektimi i aerodromit nga Autoriteti; dhe; nëse ndahet i kënaqur;
- (d) Lëshimi i certifikatës së aerodromit.

2.2 Aplikimi për një certifikatë aerodromi

2.2.1 Aplikimi për të marrë një certifikatë aerodromi duhet të bëhet me shkrim në formë të paraparë për një certifikatë aerodromi. Aplikacioni duhet të përfshijë:

- (a) një kopje të manualit të shërbimeve dhe operimeve të aerodromit,
- (b) dëshmi për të drejtën e shfrytëzimit të ligjshëm të tokës dhe të operimit me aerodromin,
- (c) çdo lloj tjetër të dëshmive dokumentuese në mbështetje të të gjitha çështjeve në aplikacion.

2.2.2 Aplikuesi duhet të paguajë të gjitha tarifat apo pagesat e zbatueshme siç janë të përshkruara nga Autoriteti.

2.2.3 Aplikuesi duhet të dorëzojë aplikacionin në kohë të mjaftueshme që të lejojë shqyrtim dhe inspektim të hollësishëm të objekteve para se të lëshojë certifikatën.

2.2.4 Aplikuesi duhet të jetë ose pronari i aerodromit/tokës ose ka marrë autorizimin ligjor për të menaxhuar dhe shfrytëzuar token për një aerodrom.

2.2.5 Aplikuesi duhet të jep informata të plota për objektet, për të dhënat teknike dhe procedurat operative në lidhje me kërkesat e certifikatës.

2.2.6 Aplikuesi duhet të informojë Autoritetin për çdo ndryshim të mundshëm në aktivitetet e tija operative, në menaxhimin e personelit dhe të dhënave të aerodromit.

2.2.7 Është me rëndësi që aplikuesit të jenë të vetëdijshëm për kërkesat specifike, rregulloret, dhe rregullat e zbatueshme për menaxhim dhe operim të aerodromit të propozuar dhe të jenë të përgatitur të paraqesin të gjitha dokumentet dhe metodat e pajtueshmërisë.

2.2.8 Format e aplikimit për një certifikatë aerodromi mund të merren nga Autoriteti.

2.3 Vlerësimi i aplikacionit

2.3.1 Me pranimin e aplikacionit Autoriteti mund të :

- (a) urdhërojë aplikuesin që të sjell çfarëdo informate shtesë e cila mund të nevojitet; dhe
- (b) kryejë inspektimin e objekteve apo parametrave dhe standardeve të mirëmbajtjes që të siguroje se aerodromi i propozuar është i sigurt për operacione të avionëve; apo
- (c) kur të jetë i sigurt në lidhje me kompetencën e aplikuesit se ka siguruar operim të sigurt, atëherë lëshon certifikatën e aerodromit

2.3.2 Autoriteti do të kërkojë që të jetë i sigurt se aplikuesi është i aftë të sigurojë kontroll efektiv të menaxhimit të të gjitha aktiviteteve të cilat janë thelbësore për operim të sigurt. Këto përfshijnë:

- (a) Një shkallë të shërbimit që plotëson kërkesat e certifikatës;
- (b) Aftësi për të kryer procedura efektive të emergjencës;
- (c) Ofrimin e minimumeve operative në lidhje me secilën procedurë të afrimit;
- (d) Personel të përshtatshëm, pajisje, objekte, manuale, ndërtesa dhe marrëveshje shërbimi; dhe
- (e) Vendosjen e një Sistem efektiv të Menaxhimit të Sigurisë.

2.4 Inspektimet dhe auditimet e aerodromit

2.4.1 Mbajtësi apo aplikuesi për certifikate aerodromi, është i obliguar që të lejojë Autoritetin apo përfaqësuesit e autorizuar të saj të kryejnë inspektime dhe auditime që të mundësojnë Autoritetin të jetë i sigurt se:

- (a) Kushtet fizike në zonën e manovrimit, platformës dhe në rrethojat e aerodromit janë të përshtatshme;
- (b) Niveli i pajisjeve dhe objekteve të dhëna të jetë i përshtatshëm për aktivitete fluturimi të cilat priten të zhvillohen;
- (c) Mbajtësi apo aplikuesi i certifikatës është në gjendje të sigurojë një Sistem efektiv të Menaxhimit të Sigurisë;

- (d) Mbajtësi apo aplikuesi i certifikatës është në gjendje të sigurojë një organizim efektiv të menaxhimit të aerodromit.

2.4.2 Pas dhënies së një certifikate, do të bëhen inspektime/auditime periodike nga ana e Autoritetit apo nga përfaqësuesit e autorizuar të saj për të siguruar përputhshmëri me kërkesat e certifikimit dhe standardeve të sigurisë. Normalisht një njoftim paraprak do t'i jepet mbajtësit të certifikatës, mirëpo inspektimet gjithashtu mund të kryhen edhe pa ndonjë paralajmërim.

2.4.3 Inspektimet janë element i rëndësishëm i certifikimit të aerodromeve dhe duhet të kryhen për të përcaktuar se mbajtësi i një certifikate është në gjendje të sigurojë menaxhim efektiv të aerodromit dhe të atyre aktiviteteve të cilat janë të ndërlidhura me operim të sigurt të aerodromit, avionëve dhe personelit.

2.5 Dhënia e certifikates së aerodromit

2.5.1 Pas përfundimit të vlerësimit preliminar të aplikacionit apo programit të inspektimit, rasti duhet të rekomandohet tek Autoriteti nga ana e inspektorit(ve) që aplikuesi është gjithashtu -

- (a) I pajisur dhe i aftë në të gjitha fushat për menaxhim dhe operim të sigurtë të aerodromit të propozuar, në pajtueshmëri me kushtet dhe kufizimet e specifikuar; apo
- (b) nuk është, apo ende nuk është i gatshëm për menaxhim dhe operim të aerodromit të propozuar në mënyrë të pranueshme.

2.5.2 Me rastin e pranimit e raportit të vlerësimit apo rekomandimeve të inspektorëve, dhënë se Autoriteti është i kënaqur me raportin e vlerësimit dhe rekomandimet e inspektimit, aplikuesit do ti lëshohet një certifikatë aerodromi e cila ndërlidhet me kushtet të cilat Autoriteti mendon që ti vendosë për të siguruar operacione të sigurt të avionëve në aerodrom të certifikuar.

2.5.3 Mbajtësit e certifikatës së aerodromit kërkohen të mirëmbajnë aerodromin në pajtueshmëri me standardet e parashtruara, karakteristikat fizike dhe procedurat e dhëna në Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit.

2.6 Llojet e certifikatës së aerodromit

2.6.1 Aplikuesit mund ti jepet një certifikatë aerodromi për operacione të transportit ajror, dhe orët e operimit të një aerodromi duhet të njoftohen tek Autoriteti për publikim në AIP.

2.7 Ndryshimi i certifikates së aerodromit

2.7.1 Autoriteti mund të ndryshojë një Certifikatë Aerodromi nëse:

- a) ka ndryshim të operatorit të aerodromit; ose
- b) ka ndryshim në shfrytëzim apo operim të aerodromit; ose
- c) ka ndryshim në kufijtë e aerodromit; ose
- d) mbajtësi i një certifikate aerodromi kërkon ndryshimin

2.8 Kushtet për certifikatë aerodromi

2.8.1 Rregullorja e tanishme për Aerodromet siguron që Autoriteti mund të lëshojë një certifikatë sipas atyre kushteve siç i parasheh se janë të përshtatshme.

2.9 Tarifa e certifikatës

2.9.1 Tarifa e certifikatës do të përcaktohet nga Autoriteti. Detajet rreth tarifës së certifikimit mund të merren nga Autoriteti.

2.10 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e certifikatës

2.10.1 Në pajtueshmëri me Rregulloren 1/2008 për Aerodromet, një certifikatë aerodromi qëndron në fuqi 5 vite nga data e dhënies së saj, përveç nëse ndërprehet apo pezullohet nga ana e Drejtorit Gjeneral të AAC-së.

2.10.2 Një Aerodrom i certifikuar për operacione të transportit ajror, duhet të jetë në dispozicion për të gjithë personat në kushte dhe terme të barabarta.

2.10.3 Mbajtësi i një certifikate aerodromi e cila i skadon apo anulohet duhet të dorëzojë certifikatën menjëherë tek Autoriteti

2.11 Pagesat ne aerodrom të certifikuar

2.11.1 Mbajtësi i certifikatës së aerodromit do të paguajë tarifa për mirëmbajtje të certifikatës siç mund ti parashtrijë Autoriteti.

2.12 Përrjashtimet

2.12.1 Autoriteti mund të bejë përjashtim, me shkrim, për një operator të aerodromit nga përputhja me dispozitat e caktuara të Rregullores 1/2008 për Aerodromet, pasi që të merr parasysh të gjithë faktorët relevant në lidhje me interesin e sigurisë.

2.12.2 Atëherë kur një aerodrom nuk plotëson kërkesën e një standardi siç kërkohet në Rregulloren 1/2008 për Aerodromet, operatori i aerodromit duhet të bëjë studime aeronautike, në bazë të së cilave e cakton Autoriteti, vetëm dhe nëse lejohet nga standardet, kushtet dhe procedurat që kanë të bëjnë me standardet, që janë te nevojshme për të mundësuar një shkallë të sigurisë të barabartë me atë që e mundëson standardi i vendosur.

2.12.3 Devijimi nga një standard dhe nga kushtet e procedurat duhet të caktohet në miratimin e certifikatës së aerodromit ose në rastin e kundërt me shkrim. Nëse një përjashtim behet ndryshe me shkrim ai duhet të përfshihet në Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit.

KAPITULLI 3: Kërkesat e certifikimit

3.1 Kërkesat e planit të aerodromit

3.1.1 Për të marrë një certifikatë të aerodromit, Aplikuesi duhet të sigurojë që aerodromi është pajisur me:

- (a) Karakteristikat fizike;
- (b) Sipërfaqet për kufizim të pengesave;
- (c) Ndriçim për -
 - (i) navigim;
 - (ii) paraqitjen e pengesave; dhe
 - (iii) paraqitjen e zonave me përdorim të ndaluar;
- (d) pajisjet dhe instalimet -
që janë në përputhshmëri me karakteristikat e avionëve me të cilat ka ndërmend të shërbejë.

3.1.2 Karakteristikat fizike, Sipërfaqet për kufizim të pengesave, ndriçimet, dhe pajisjet dhe instalimet e dhëna në aerodrom duhet të jenë të pranueshme për Autoritetin.

3.2 Kufizimet e aerodromit

3.2.1 Për një certifikatë aerodromi, një aplikues duhet, atëherë kur është e nevojshme për sigurinë e operimeve të avionëve në aerodromet e tyre, të njoftojë Autoritetin për çdo kufizim të shfrytëzimit të aerodromit kufizim ky që rrjedh nga dizajnimi i aerodromit apo nga objektet dhe shërbimet e ofruara në aerodrom.

3.3 Kërkesat e personelit

3.3.1 Për një certifikatë aerodromi, Aplikuesi duhet të angazhojë, punësojë apo kontraktojë

- (a) Një zyrtar të lartë i identifikuar si Menaxher Përgjegjës i cili është i pranueshëm për Autoritetin, dhe i cili ka përgjegjshmërinë për të siguruar pajtueshmërinë me kriteret e certifikimit;
- (b) Një Menaxher për Siguri i cili është i pranueshëm për Autoritetin dhe që i cili është përgjegjës për zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë;

- (c) Një Menaxher për Operime i cili është i pranueshëm për Autoritetin dhe që i cili është përgjegjës për operim të përditshëm në pajtueshmëri me Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit;
- (d) Personeli Operativ dhe i Mirëmbajtjes i cili është përgjegjës për të siguruar se aerodromi dhe operimet e tija janë në përputhje me kërkesat e këtij manuali të certifikimit të aerodromit;
- (e) Personel të mjaftueshëm për të operuar dhe mirëmbajtur aerodromin me shërbimet dhe objektet e tija.

3.4 Plani emergjent i aerodromit

3.4.1 Për një certifikatë aerodromi, aplikuesi duhet të zhvillojë dhe të mirëmbajë një plan emergjent të hartuar që të minimizojë mundësinë dhe shtrirjen e lëndimit personal apo dëmit në pronë, apo në afërsi të asaj prone në raste emergjente në aerodrom.

3.4.2 Plani emergjent i Aerodromit duhet të përfshijë:

- (a) Procedurat për t'u marrë me të gjitha llojet e emergjencave që janë të realizueshme në mënyrë të arsyeshme; dhe
- (b) detaje të mjaftueshme për të ofruar udhëzime adekuate për çdo person i cili duhet të veprojë në përputhje me planin; dhe
- (c) detajet e secilës agjenci të përfshirë në këtë plan si dhe përgjegjësinë dhe rolin e secilës prej tyre; dhe
- (d) për aerodromet ndërkombëtare, furnizimin për qendër për operime emergjente të pajisur në mënyrë adekuate dhe qendër komanduese për çfarëdo lloji të emergjencës; dhe
- (e) një përshkrim të pajisjeve në dispozicion duke përfshirë pajisjet mjekësore dhe vendndodhjen e pajisjeve; dhe
- (f) informatë për emrat dhe numrit të telefonit të zyrtarëve dhe të personave që duhet të kontaktohen në raste të ndonjë emergjence; dhe
- (g) një hartë rrjeti të aerodromit dhe afërsisë së saj.

3.4.3 Aplikuesi duhet të:

- (a) Bashkërendojë planin e vet të emergjencës së aerodromit me agjencionet për zbatim të ligjit, linjave ajrore, ofrueseve të sigurisë,

agjencioneve të shpëtimit dhe zjarrfikjes, organizatave mjekësore, përdoruesve kryesor të aerodromit, dhe të gjithë personave/agjencive të tjerë të cilët kanë përgjegjësi në plan; dhe

- (b) Deri në një masë të praktikueshme të ofrojë pjesëmarrje nga të gjitha agjencitë e specifikuar në paragrafin 3.4.3 (a) në zhvillimin e planit emergjent të aerodromit.

3.5 Shërbimet e shpëtimit dhe zjarrfikjes

3.5.1 Përcaktimet e kategorive

3.5.1.1 Aplikuesi për certifikate aerodromi duhet të përcaktojë kategorinë e shpëtimit dhe zjarrfikjes të një aerodromi i cili, sipas paragrafit 3.5.1.2 duhet të jetë sipas llojit më të madh të aeroplanëve që përdorin rregullisht aerodromin siç është dhënë në tabelën 1

3.5.1.2 Një aplikues për një certifikatë aerodromi mund të:

- (a) kur numri i lëvizjeve të aeroplanëve është më i vogël se 700 në 3 muajt më të zënë të vitit dhe atë rresht, të përcaktojë që kategoria e aerodromit të jetë një më e vogël se sa ajo që është treguar në Tabelën 1.

Kategoria e Aerodromit	Gjatësia e përgjithshme e Aeroplanit	Gjerësia Maksimale e Trupit
(1)	(2)	(3)
1	0m deri në por nuk përfshin 9m	2m
2	9m deri në por nuk përfshin 12m	2m
3	12m deri në por nuk përfshin 18m	3m
4	18m deri në por nuk përfshin 24m	4m
5	24m deri në por nuk përfshin 28m	4m
6	28m deri në por nuk përfshin 39m	5m
7	39m deri në por nuk përfshin 49m	5m
8	49m deri në por nuk përfshin 61m	7m
9	61m deri në por nuk përfshin 76m	7m
10	76m deri në por nuk përfshin 90m	8m

Tabela 1: Kategoria e Aerodromit për shpëtim dhe zjarrfikje

- Shënim: (1) Të kategorizojë aerodromin sipas llojit më të madh të avionit që rregullisht përdorin aerodromin, së pari të vlerësojë gjatësinë përgjithshme të tyre dhe, së dyti, gjerësinë e trupit të avionit.
- (2) në qoftë se, pas zgjedhjes së kategorisë përshtatur sipas gjatësisë së përgjithshme të një aeroplani, për atë se gjerësia e trupit të aeroplanit është më e madhe se sa gjerësia maksimale në kolonën (3) për atë kategori, atëherë kategoria e aerodromit për atë madhësi të aeroplanit është për një kategori më e lartë.

3.5.2 Agjentët e fikjes

3.5.2.1 Aplikuesi për certifikate aerodromi duhet të ketë minimumin e agjentëve të fikjes sikur që kërkohet nën aneksin 14 të ONAC-it dhe siç është dhënë në Tabelën 2.

Kategoria e Aerodromit	Shkuma që arrin performancë deri në nivelin B		Agjentët plotësues		
	Ujë (L)	Norma e shkarkimit të shumës për minutë (L)	Pluhur i thatë kimikal apo Halon apo CO2		
			(kg)	(kg)	(kg)
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)
1	230	230	45	45	90
2	670	550	90	90	180
3	1200	900	135	135	270
4	2400	1800	135	135	270
5	5400	3000	180	180	360
6	7900	4000	225	225	450
7	12100	5300	225	225	450
8	18200	7200	450	450	900
9	24300	9000	450	450	900
10	32300	11200	450	450	900

Tabela 2: Shumat minimale të shfrytëzueshme për agjentët zjarrfikës.

3.5.3 Automjetet

3.5.3.1 Aplikuesi për certifikatë aerodromi duhet të ketë një minimum të automjeteve të shpëtimit dhe zjarrfikjes për kategorinë e përcaktuar sipas Aneksit 14 të ONAC-it, dhe siç është dhënë në Tabelën 3

Kategoria e Aerodromit	Automjetet e Shpëtimit dhe Zjarrfikjes
1	1
2	1
3	1
4	1
5	1
6	2
7	2
8	3
9	3
10	3

Tabela 3: Automjetet minimale të shpëtimit të zjarrfikjes:

3.5.3.2 Çdo automjet që kërkohet sipas paragrafit 3.5.3.1 duhet të jetë i pajisur me radio komunikimi me zë të dyanshëm, së paku -

- (a) secili automjet tjetër i shpëtimit dhe zjarrfikjes që kërkohet për aerodrom; dhe
- (b) Shërbimi i kontrollit të aerodromit apo shërbimi informativ i fluturimit në aerodrom; dhe
- (c) Stacionet tjera siç janë të specifikuara nga aplikuesit në planin emergjent të aerodromit.

3.5.3.3 Secili automjet siç kërkohet nga paragrafi 3.5.3.1 duhet të:

- (a) ketë një sinjal ndezës apo rrotullues; dhe
- (b) jetë i shënjuar me një ngjyrë të kuqe të dukshme.

3.5.4 Kërkesat për personel

Aplikuesi për certifikate aerodromi duhet të krijojë një procedurë për të siguruar që i tërë personeli i shpëtimit dhe zjarrfikjes në aerodrom janë:

- (a) pajisur me rroba adekuate mbrojtëse dhe pajisje të shpëtimit, të nevojshme për të kryer detyrat e tyre;
- (b) të aftë fizikisht dhe nga shëndeti;
- (c) tu ofrohet trajnim periodik dhe praktika të rregullta për të mbajtur kompetencat e tyre në përdorimin e pajisjeve të shpëtimit dhe të zjarrfikjes;
- (d) të mjaftueshëm në numër dhe të jenë në dispozicion të operojnë automjetet dhe pajisjet e shpëtimit dhe zjarrfikjes deri në maksimumin e kapacitetit; dhe
- (e) Të reagojë menjëherë në çdo emergjencë ekzistuese apo kërcënuese kur kërkohet ndihma e tyre.

3.5.5 Aftësia e reagimit

Për certifikatë aerodromi, aplikuesi duhet të, mirëmbajë aftësitë e mëposhtme reaguese të shpëtimit dhe zjarrfikjes:

- (a) brenda 3 minutave nga koha e alarmit, personeli dhe makinat e nevojshme të shpëtimit dhe zjarrfikjes duhet të lëshojnë shkumë në një normë se paku deri në 50 për qind të normës së specifikuar në Tabelën 2 për kategorinë e aerodromi, duhet të jenë në gjendje të arrijnë pikën më të largët të zonës së lëvizjes nga postet e tyre të caktuara dhe të jenë në gjendje që në atë pikë që të lëshojnë atë sasi të shkumës.
- (b) brenda një minutë pas arritjes së automjetit të pare reagues apo automjeteve dhe personelit, të gjitha automjetet tjera të kërkuara në kategorinë e aerodromit nga Tabela 3 dhe i tërë personeli i nevojshëm

duhet të jenë në gjendje të dërgojnë një pjesë të agjentëve të fikjes në normën për shkarkim siç është specifikuar në tabelën 2 të kategorisë së aerodromit.

3.6 Mbrojtja publike

3.6.1 Aplikuesi për certifikatë aerodromi duhet të sigurojë:

- (a) masa mbrojtëse për të parandaluar hyrjen e shtazëve të hutuara në zonën e lëvizjes, dhe masa mbrojtëse për të parandaluar hyrjen e personave apo makinave të paautorizuara në zonat operative të aerodromit; dhe
- (b) mbrojtje të arsyeshme të personave dhe pronës nga shpërthimet e ajrit që dalin nga avionët.

3.6.2 Masat e kërkuara mbrojtëse duhet:

- (a) që në zonat ngjitur me zonat operative të aerodromit në të cilat publiku ka qasje të drejtpërdrejte me automjet apo në këmbë të ketë vazhdimisht ndalesa të cilat mund të përfshijnë strukturat ekzistuese, portat dhe dyert me qasje të kontrolluar
- (b) që në zonat tjera, masat mbrojtëse duhet të jenë sipas nenit 64 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe sipas Manualit të AAC-së për "Zonat Mbrojtëse të Aeroportit".

3.7 Menaxhimi i rezikshmërisë nga shtazët

3.7.1 Aplikuesi për certifikatë aerodromi duhet, aty ku ndonjë shtazë paraqet një rrezik të operimeve të avionëve në aerodrom, të krijojë një program për menaxhim të mjedisit që të eliminojë ose minimizojë çdo rrezikshmëri nga shtazët

3.8 Garantimi i sigurisë së brendshme të aerodromit

Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë nga operatorët e Aerodromit

3.8.1 Aplikuesi apo operatori duhet të vendos një Sistem për Menaxhim të Sigurisë për menaxhim të sigurve në aerodrom duke përfshirë strukturën organizative, përgjegjësitë, procedurat, proceset dhe dispozitat për zbatimin e politikave të sigurisë nga operatori i aerodromit, i cili ofron kontroll dhe shfrytëzim të sigurve aerodrom.

3.8.2 Operatori i Aerodromit duhet të caktoj një auditim të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë duke përfshirë një inspektim të objekteve dhe pajisjeve të aerodromit. Auditimi duhet të mbulojë funksionet vetanake të Operatorit të Aerodromit.

3.8.3 Personi përgjegjës për Siguri duhet të ketë qasje të drejtpërdrejtë tek Menaxheri Përgjegjës në çështjet të cilat kanë të bëjnë me operimet e avionëve dhe performancën e shërbimeve dhe pajisjeve të aerodromit

3.9 Manuali i Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit

3.9.1 Hyrje

Aplikuesi për certifikatë aerodromi duhet të sigurojë për Autoritetin një Manual të Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit i cili duhet të jetë i qartë, i plotë, dhe me udhëzime të detajizuara, me politika dhe procedura për përdoruesit e vet në mënyrë që të jenë të plotësisht të informuar se çka kërkohet prej tyre. Aplikuesi duhet të udhëzohet nga ky Kapitull dhe Kapitulli 2 i Rregullores 1/2008 për Aerodromet në përgatitjen e Manualit të Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit.

3.9.2 Përmbajtja e Manualit

Manuali i Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit duhet të përfshijë informata dhe udhëzime në lidhje me çështjet vijuese:

- (a) një deklaratë të nënshkruar nga Menaxheri Përgjegjës, në emër të organizatës së aplikuesit, që konfirmon se manuali:
 - (i) përcakton organizatën dhe demonstroi mënyrat dhe metodat e veta për të garantuar pajtueshmëri të vazhdueshme të manualit për certifikim të Aerodromit
 - (ii) duhet të jetë gjithëherë në pajtueshmëri të plotë me
- (b) titullin dhe emrin e personit apo personave të lartë siç kërkohet në paragrafin 3.3.1
- (c) detyrat dhe përgjegjësitë e personit apo personave të lartë siç janë specifikuar në paragrafin 3.3.1 (b) duke përfshirë çështje për të cilat ata kanë përgjegjësi të merren drejtpërdrejtë me Autoritetin në emër të Organizatës
- (d) një skemë organizative që tregon linjat e përgjegjësive të personit apo personave të lartë siç janë specifikuar në paragrafin 3.3.1 (b)
- (e) çfarëdo kufizimi i vendosur nën paragrafin 3.2

- (f) detajet e çfarëdo përjashtimi të bërë për aplikuesin
- (g) plani emergjent i aerodromit kërkuar sipas paragrafit 3.4
- (h) një deklaratë e kategorisë së shpëtimit dhe zjarrfikjes e përcaktuar sikur nën 3.5 me përshkrim të kërkuar të agjentëve të fikjes, automjeteve, procedurave dhe personelit
- (i) një përshkrim për masat mbrojtëse për sigurinë publike kërkuar sipas paragrafit 3.6
- (j) procedurat që kërkohen sipas paragrafit 3.8 për njoftimin e të dhënave dhe informatave të aerodromit
- (k) programi i mirëmbajtjes së aerodromit kërkuar sipas paragrafit 4.2
- (l) procedurat e kërkuara sipas paragrafit 4.3 për mirëmbajtje parandaluese dhe kontrollim të ndriçimit për navigim
- (m) procedurat dhe masat paraprake të kërkuara sipas paragrafit 4.4 për çfarëdo pune në aerodrom
- (n) procedurat e kërkuara sipas paragrafit 4.5 për mirëmbajtjen e planit emergjent të aerodromit
- (o) programi inspektiv i aerodromit, procedurat dhe sistemi raportues i kërkuar sipas paragrafit 4.9
- (p) procedurat e kërkuara sipas paragrafit 4.10 për kontrollin e automjeteve
- (q) procedurat e kërkuara sipas paragrafit 4.13 për kufizimin e operimeve të avionëve nëse ndodh ndonjë papajtueshmëri e kushteve të aerodromit
- (r) procedurat për kontrollim, ndryshim, dhe shpërndarje të Manualit të Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit
- (s) Një Sistem të Menaxhimit të Sigurisë (SMS) për të siguruar përputhshmëri me të gjitha kërkesat e sigurisë dhe arritje të vazhdueshme të përmirësimit në performancën e sigurisë dhe të ketë veçoritë si në vijim:
 - (i) Politikë të sigurisë, për aq kohë sa është e zbatueshme, në procesin e menaxhimit të sigurisë dhe ndërlidhjen e saj me procesin operativ dhe atë të mirëmbajtës

- (ii) struktura apo organizimi i SMS-ë duke përfshirë personelin dhe funksionin e përgjegjësive individuale dhe grupe të çështjeve të sigurisë
- (iii) Strategjia dhe planifikimi i SMS, siç është vendosja e objektivave të performancës së sigurisë, ndarja e prioritetëve për zbatimin e iniciativave dhe dhënia e një kornize për mbajtjen e rrezikut në një nivel sa me të vogël të mundshëm duke pas parasysh gjithmonë kërkesat e Standardeve dhe Praktikave të Rekomanduara të Aneksit 14, Volumi I për Konventën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil dhe rregulloret kombëtare, standardeve, normave dhe rregullave.
- (iv) zbatimi i SMS-së përfshirë objektet, metodat dhe procedurat për komunikim efektiv të porosive të sigurta dhe për përforsim të kërkesave të sigurisë
- (v) një sistem për zbatim të, dhe veprim në, zonat kritike të sigurisë të cilat kërkojnë një nivel më të lartë integriteti të menaxhimit të sigurisë
- (vi) masat për mbështetje të sigurte, parandalim të aksidentëve dhe një sistem për kontrollin e rrezikut përfshirë analizat dhe trajtimin e aksidentëve, incidentëve, ankesave, defekteve, gabimeve, mospajtimeve dhe dështimeve, dhe vazhdueshmërisë të mbikëqyrjes së sigurisë
- (vii) një sistem të sigurisë dhe shqyrtimit të auditimit të brendshëm që detajizon sistemet dhe programet për kontroll të kualitetit mbi sigurinë
- (viii) një sistem për dokumentimin e të gjitha objekteve të aeroportit që kanë lidhje me sigurinë si dhe me të dhënat operative dhe të mirëmbajtjes së aerodromit, duke përfshirë informacione për projektimin dhe shtresimin e sipërfaqeve për avionë dhe ndriçimin e aerodromit. Sistemi duhet të mundësojë rikthim të lehtë të të dhënave përfshirë edhe skicat
- (ix) trajnim dhe kompetencë të personelit, përfshirë shqyrtimin dhe vlerësimin e përshtatshmërisë së trajnimit dhënë personelit për detyrat që kanë të bëjnë me sigurinë dhe sistemin e certifikimit për testimin e kompetencave të tyre

(x) përfshirjen dhe zbatimin e klauzolave që kanë të bëjnë me sigurinë në kontratat për punë në aerodrom

3.9.3 Mbajtësi i certifikatës duhet të bëjë ndryshime të tilla në manual siç mund t'i kërkojë Autoriteti me qëllim të sigurimit se aerodromi është i sigurt për t'u shfrytëzuar nga avionët ose për sigurinë, efikasitetin ose rregullsinë e navigimit ajror.

3.9.4 Të gjitha ndryshimet në manual duhet të dorëzohen tek Autoriteti për shqyrtim dhe pranim. Autoriteti mund të kërkojë rishikimin e përmbajtjes sipas nevojës për të arritur përshtatshmëri me kërkesat e sigurisë dhe më rregulloret në fuqi.

KAPITULLI 4: Kërkesat operuese

4.1 Pajtueshmëria e vazhdueshme

Mbajtësi i certifikatës së aerodromit duhet të:

- (a) pajtohet me të gjitha procedurat, planet, sistemet dhe programet që janë detajuar në Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit; dhe
- (b) bëjë të disponueshëm për të gjithë personelin operativ të gjitha ato pjesë të aerodromit që janë thelbësore për detyrat e tyre;

4.2 Mirëmbajtja e aerodromit

4.2.1 Mbajtësi i një certifikatë të aerodromit duhet të vendos programe të mirëmbajtjes dhe inspektimit që të ruaj objektet e aerodromit në ato kushte që nuk e pengojnë mbrojtjen, sigurinë, rregullsinë apo efikasitetin e operimeve së avionëve.

4.2.2 Mbajtësi i certifikatës duhet të mbajë sipërfaqen e zonave të manovrimit larg çfarëdo lloji të objekteve që mund të rrezikojnë operimet e avionëve.

4.2.3 Mbajtësi i certifikatës duhet të mirëmbajë sipërfaqen e pistave në një gjendje të mirë në mënyrë që të sigurojë karakteristika të mira të fërkimit.

4.3 Ndriçimi për navigacion/mirëmbajtje/kontroll

Mbajtësi i certifikatës së aerodromit duhet të krijojë procedura për të siguruar se sistemi i mirëmbajtjes parandaluese dhe kontrollit të ndriçimit të aerodromit për navigim është vendosur në mënyrë që të -

- (a) sigurojë që secili ndriçim për navigim jep udhëzim të saktë dhe të besueshëm për shfrytëzuesin; dhe
- (b) Krijojë një përqindje të lejuar të prishjes së dritave të cilat duhet të sigurojnë vazhdimësinë e udhëzimit për shfrytëzuesin; dhe
- (c) kthejë çdo gjë që është e pa dobishme dhe e prishur prapa në shërbim/funksion pa vonesa të panevojshme.

4.4 Punët në aerodrom

Mbajtësi i certifikatës së aerodromit duhet të:

- (a) krijojë procedura dhe masa paraprake që sigurojnë se çdo punë e kryer në aerodrom nuk e rrezikon operimet e avionëve apo cenonjë sigurinë e aerodromit.
- (b) informojë Autoritetin para se të filloje apo lejojë çfarëdo pune në aerodrom sipas Manualit të AAC-së “Zhvillimi i Aerodromit”

4.5 Plani emergjent i aerodromit

Mbajtësi i një certifikate të aerodromit duhet të krijojë procedura që:

- (a) Sigurojnë së i tërë personeli i aerodromit; ka detyrat dhe përgjegjësitë emergjente të aerodromit që sipas planit emergjent të aerodromit janë të njoftuar me detyrat dhe se janë të trajnuar siç duhet; dhe
- (b) Testojë planin emergjent të aerodromit duke kërkuar -
 - (i) një shkallë të plotë ushtrimesh emergjente të aerodromit së paku një herë në dy vite
 - (ii) Ushtrime të posaçme emergjente në vitin ndërhyrës për të siguruar se çdo mangësi e gjetur gjatë ushtrimeve emergjente të aerodromit të shkallës së plotë është korrigjuar; dhe
- (c) shqyrtojë planin pas secilit ushtrim të veçuar si në nën-paragrafin (b) dhe pas një emergjence aktuale në mënyrë që të korrigjojë të gjitha mangësitë e gjetura

4.6 Kërkesat operuese të shpëtimit dhe zjarrfikjes

4.6.1 Secili mbajtës i certifikatës së aerodromit duhet të sigurojë kapacitetin e aftësive të shpëtimit dhe zjarrfikjes së aerodromit që plotëson kërkesat minimale sipas paragrafit 3.5.2 dhe 3.5.3.

4.6.2 Përveç siç parashihet në paragrafin 4.6.3, nëse një rritje në lëvizjet apo një ndryshim në llojin e transportit ajror të aeroplanëve duke përdorur aerodromin, rezulton në një rritje të kategorisë siç parashihet në paragrafin 3.5.1, mbajtësi i certifikatës duhet të rrisë aftësitë e tija të shpëtimit dhe zjarrfikjes deri në minimumin e kërkuar për atë kategori të lartë sipas paragrafit 3.5.2 dhe 3.5.3.

4.6.3 Sipas paragrafit 4.6.4, gjatë çdo periudhe të kufizimit të operimeve për aeroplanët që kanë një specifikë më të ulët se sa ajo që është normalisht e aplikueshme nën 3.5.1, mbajtësi i certifikatës mund ta zvogëlojë kapacitetin e

shpëtimit dhe zjarrfikjes në një nivel më të ulët të kërkuar për kategoritë e aerodromeve që korrespondon me veçantitë më të larta të aeroplanëve që rregullisht shfrytëzojnë aerodromin.

4.6.4 Çdo zvogëlim në aftësitë e shpëtimit dhe zjarrfikjes sipas paragrafit 4.6.3 duhet të jetë temë e kushteve siç vijojnë:

- (a) procedurat për, dhe personat që kanë autoritetin të zbatojnë zvogëlimet duhet të përfshihen në Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit
- (b) procedurat për anulimin e të gjitha kapaciteteve të shpëtimit dhe zjarrfikjes në aerodrom duhet të përfshihen në Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit;
- (c) Zvogëlimet nuk mund të zbatohen përveç nëse informata i përcillet Autoritetit për publikim të përshtatshëm.

4.6.5 Mbajtësi i certifikatës duhet të vendos një sistem për mirëmbajtje preventive të automjetit apo automjeteve të veta të shpëtimit dhe zjarrfikjes që të garantojë efektivitetin e pajisjeve dhe përshtatshmërinë me reagim të kërkuar kohor përgjatë jetës së secilit automjet.

4.6.6 Mbajtësi i certifikatës duhet të ndërrojë menjëherë çdo automjet të shpëtimit dhe zjarrfikjes i cili bëhet jo funksional dhe atë deri në atë masë kur mbajtësi i certifikatës nuk mund t'i plotësojë nevojat e kërkuara sipas paragrafit 3.5.5. Nëse automjeti zëvendësues nuk është i disponueshëm menjëherë, mbajtësi i certifikatës duhet të jap njoftimin e kërkuar sipas paragrafit 4.12. Nëse përgjigja e kërkuar e aftësive nuk është dhënë brenda 48 orëve, mbajtësi i certifikatës duhet të kufizojë operimet e transportit ajror në aerodrom për ata aeroplanë që janë në pajtim me kategorinë e aerodromit dhe që korrespondon me automjetin dhe automjetet e mbetura operative të shpëtimit dhe zjarrfikjes.

4.6.7 Mbajtësi i certifikatës duhet të, që me pajisjet e shpëtimit dhe zjarrfikjes të kërkuara sipas këtij manuali dhe numrit të personelit të trajnuar i cili duhet të sigurojë një funksionalitet efektiv, që të reagojë në çdo emergjencë gjatë operimeve siç janë të veçuara në paragrafin 4.6.1.

4.7 Menaxhimi i trafikut ajror të aerodromit

4.7.1 Mbajtësi i një certifikate të aerodromit duhet të sigurojë dispozitat e një shërbimi informativ të fluturimit në aerodrom apo një shërbim kontrolli të aerodromit apo që të dyja në aerodrom atëherë kur kërkohet nga Autoriteti.

4.8 Shërbimi i menaxhimit të platformës

4.8.1 Mbajtësi i certifikatës së aerodromit duhet të sigurojë që aerodromi të jetë i pajisur me shërbim të menaxhimit të platformës sipas volumit të kushteve të trafikut dhe kushteve operuese.

4.8.2 Operator i Aerodromit duhet të sigurojë se ka zhvendosje e sigurte të kontrollit në mes të njësive që operojnë në aerodrom.

4.9 Plani i inspektimit të aerodromit

4.9.1 Mbajtësi i një certifikate të aerodromit duhet të themelojë një program inspektimi për aerodromin që të sigurojë pajtueshmëri me këtë manual dhe duhet të sigurojë:

- (a) pajisje për përdorim në kryerjen e programit të inspektimit të aerodromit
- (b) procedurat për të siguruar që personeli i kualifikuar i aerodromit përmbush programin e inspektimit të aerodromit
- (c) një sistem raportimi që siguron një korrigjim të shpejtë të kushteve të pasigurta të aerodromit që vërehen gjatë çfarëdo ndonjë inspektimi
- (d) procedurat për raportim në KTA (kontrolli i trafikut ajror) pas kryerjes së inspektimit të aerodromit

4.9.2 Operatori i Aerodromit duhet të mbajë të dhëna për çfarëdo mangësie e cila do të mund të cenonte sigurinë e operimit.

4.9.3 Operatori i Aerodromit duhet të mbajë të dhëna për secilin inspektim për një periudhë prej 2 viteve pas inspektimit.

4.10 Automjetet e terrenit

4.10.1 Mbajtësi i certifikatës së aerodromit duhet të:

- (a) kufizojë qasje në zonat operative të aerodromit vetëm për ato automjete terreni që janë të domosdoshme për operimet e aerodromit dhe avionëve.
- (b) të sigurojë procedura adekuate për qasje të sigurte dhe të rregullt të automjeteve të terrenit në zonat operative. Automjetet e terrenit që

veprojnë në një zonë operative duhet të furnizohen me pajisje adekuate të komunikimit

- (c) sigurojnë shenja adekuate për kontroll të automjeteve në aerodrom
- (d) paraqesë procedurat për automjetet për kontroll të sipërfaqes që operojnë në zonën e lëvizjes, duke përfshirë rregullat e zbatueshme të trafikut dhe metodat e lëshimit të lejeve të vozitjes brenda zonës ajrore për automjetet operative në zonën e lëvizjes

4.11 Mbrojtja e mjeteve të navigimit

4.11.1 Mbajtësi i një certifikate të aerodromit duhet të -

- (a) parandalojë ndërtimin e objekteve në aerodrom të cilat do të mund të ndikojnë negativisht në operimet e çfarëdo mjeti të navigimit elektronik apo ndriçues apo të objektit të shërbimit të trafikut ajror në aerodrom; dhe
- (b) parandalojë, aq sa të jetë nën kontroll të mbajtësit të certifikatës, çdo pengesë të sinjaleve ndriçuese apo elektronike të mbështetjeve të navigimit.

4.12 Njoftimi për kushtet e aerodromit

4.12.1 Mbajtësi i Certifikatës së aerodromit duhet të njoftojë Autoritetin dhe SHIA sa më parë që është e praktikueshme (për çështje të NOTAM-it), të çfarëdo kushti operativ të aerodromit apo të ndonjë defekti në aerodrom i cili mund ndikojë në funksionalitetin e sigurte të avionëve.

4.13 Kushtet e mospërputhjes

4.13.1 Kurdo që ndonjë kërkesë e këtij manuali nuk mund të përmbushet, mbajtësi i një certifikate të aerodromit duhet të kufizojë operimet e avionëve në përputhshmëri me rrethanat.

4.14 Ndryshimet në organizimin e mbajtësit të certifikatës

4.14.1 Mbajtësi i një certifikate të aerodromit duhet të sigurojë që Manuali i Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit të jetë i ndryshuar sipas nevojës që të pasqyrojë gjendjen aktuale të operimeve.

4.14.2 Mbajtësi i një certifikate duhet të sigurojë që ndryshimet në Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit janë shpërndarë tek secili mbajtës i

manualit pa ndonjë vonesë dhe të sigurojë një kopje të secilit ndryshim në manual sa më parë që është praktike pas përfshirjes së tij në Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit.

4.14.3 Atëherë kur mbajtësi i certifikatës propozon të bëjë ndonjë ndryshim në ndonjërin prej këtyre, kërkohet njoftimi dhe pranimi paraprak nga Autoriteti:

- (a) Menaxheri Përgjegjës, Menaxheri për Siguri dhe Menaxheri për Operime
- (b) Objekti apo pajisjet e Aerodromit apo niveli i shërbimeve në aerodrom që ka gjasa të ndikojë saktësinë e informatave që gjenden në secilin botim të SHIA-s
- (c) Manuali i Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit

4.14.4 Autoriteti mund të përshkruajë kushtet nën të cilat mbajtësi i certifikatës do të mund të operojë gjatë apo në vazhdim të çfarëdo ndryshimi të veçuar në paragrafin 4.14.3.

4.14.5 Kur ndonjë nga ndryshimet që referohen në këtë manual kërkon një ndryshim në certifikatën e aerodromit, mbajtësi i certifikatës do ta përcjellë certifikatën tek Autoriteti sa më parë që të jetë e praktikueshme.

4.14.6 Mbajtësi i certifikatës duhet të bëjë ndryshime të tilla në Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit ashtu siç e konsideron Autoriteti të domosdoshme dhe në interes të sigurisë.

KAPITULLI 5: Sigurimi i aerodromeve

5.1 Zbatueshmëria

5.1.1 Autoriteti kompetent përgjegjës për sigurimin e aviacionit dhe zbatimin e standardeve të sigurisë në Kosovë është Ministria e Punëve të Brendshme. Ata janë përgjegjës për zbatim dhe në pajtim me konventat ndërkombëtare të atyre aspekteve të *acquis communautaire*, siç edhe mund të aplikohen për sigurinë e aviacionit civil. Ky kapitull përshkruan disa kërkesa të sigurimit të aviacionit të zbatueshme për aerodromet e certifikuara sipas rregulloreve.

5.2 Kërkesat për sigurim në aerodrome

5.2.1 Kërkesat e barrierave

5.2.1.1 Mbjtësi i certifikatës së aerodromit duhet të, sigurojë masa mbrojtëse për të parandaluar çdo qasje të pa-autorizuar në secilën zone të sigurimit brenda aerodromit të tij.

5.2.1.2 Masat mbrojtëse të kërkuara sipas paragrafit 5.2.1.1 duhet të

- (a) përbëhen nga rrethojat, portat, dyert dhe barrierat tjera në mes të zonave publike dhe të sigurisë me bllokim adekuat apo me sisteme të kontrollit; dhe
- (b) sigurojë kontroll të çfarëdo kanali, tubacioni apo tuneli që ka qasje në zonën e sigurisë apo zonat e sigurisë.

5.2.2 Kërkesat tjera

5.2.2.1 Mbjtësi i certifikatës së aerodromit duhet të:

- (a) caktojë një pozitë të izoluar parkimi për avionët në aerodromet e tyre; për parkim të një avioni i cili njihet ose besohet të jetë objekt i ndërhyrjeve të paligjshme, apo për ndonjë arsye tjetër të sigurisë nevojitet izolimi nga aktivitetet normale të aerodromit
- (b) sigurojë dhe mirëmbajë ndriçimin, dhe ndriçimin emergjent në raste të prishjes së sistemit normal të ndriçimit për zonat operative dhe zonat me qasje nga publiku
- (c) sigurojë ndriçim, apo të ketë ndriçim të mbartshëm brenda 30 minutave, në secilën zonë parkimi të përcaktuar për avionët e izoluar në aerodromet e tyre me qëllim përdorimi gjatë natës

- (d) ofrojnë zona si në vijim në aerodromet e tyre për ekzaminim dhe kalim të pasagjerëve:
- (i) zonat për ekzaminimin e pasagjerëve, dhe bagazhit para hipjes në avion
 - (ii) në zonat sterile ku pasagjerët ndërkombëtarë i nënshtrohen ekzaminimit të jenë të ndalur për të pasur qasje në artikuj të paautorizuar apo të kontaktojnë më personat e pa ekzaminuar:
 - (iii) të ndajë zonat e pasagjerëve që mbërrijnë dhe atyre që nisen në interes të sigurisë apo për të përmbushur kërkesat e sigurisë
- (e) kur konsiderohet e nevojshme në raste të ndonjë kërcënimi të sigurimit, të sigurojë zona për ekzaminim në aerodromin e tyre sipas llojit të kërkuar nga paragrafi 5.2.2.1 (d)
- (f) Sigurojë që zonat e koncesionit në aerodromet e tyre që gjenden në zona me qasje për pasagjerët e ekzaminuar të jenë të përcaktuara në atë mënyrë që tu japin qasje masave të kontrollit mjaftueshëm për të parandaluar dërgesat tek secili person i ekzaminuar si:
- (i) çdo armë zjarri
 - (ii) çdo armë apo instrument tjetër të rrezikshëm apo sulmues
 - (iii) çdo lloj të municionit
 - (iv) çdo substancë apo mjet eksploziv, ose substancë apo mjet të dëmshëm i çfarëdo lloji që mund të përdoret për të rrezikuar sigurinë e një avioni apo të personave në një avion.
- (g) përcaktojë të gjitha zonat e ekzaminimit në atë mënyrë që ato të ofrojnë qasje, masave të kontrollit mjaftueshëm për të parandaluar çdo person të paautorizuar për të hyrë zonë
- (h) Sigurojë që personeli i angazhuar, i punësuar apo i kontraktuar nga mbajtësi i certifikatës t'i nënshtrohet një programi të vetëdijesimit të sigurimit, dhe që secili person nga i cili kërkohet për të kryer detyra të veçanta të sigurimit është i trajnuar për këto detyra
- (i) krijimin e procedurave për identifikim, raportim tek autoriteti i duhur, dhe të merret me, shkeljet dhe të metat në, çdo procedurë të sigurisë të krijuar nga mbajtësi, dhe me çfarëdo dispozita të miratimit në lidhje me sigurimin në aerodrome.
- (j) kryen furnizimin për shërbime të sigurimit, duke përfshirë furnizimet me energji, komunikimet, kanalizimet dhe furnizimet me ujë, në

mënyrë që të minimizojë rrezikun e shërbimeve të tilla që të përdoren për të ndërhyrë në mënyrë të paligjshme me operacionet e aviacionit

- (k) Shenjat e fiksuara të tregojnë qartë kufijtë e zonave të sigurimit.

KAPITULLI 6: Përgjegjësi dhe struktura e lartë organizative e aerodromit

6.1 Menaxheri Përgjegjës

6.1.1 Operatori i Aerodromit duhet të identifikojë një Menaxher Përgjegjës që të jetë përgjegjës dhe i përgjegjshëm në emër të Operatorit të Aerodromit për të përmbushur kërkesat e Ligjit të Aviacionit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe Rregullores Nr. 1/2008 për Aerodromet. Menaxheri Përgjegjës duhet të jetë i pranueshëm nga Autoriteti.

6.1.2 Menaxheri Përgjegjës duhet të jetë një person i vetëm, i identifikueshëm i cili, pavarësisht nga funksionet tjera, duhet të ketë përgjegjësinë përfundimtare për të siguruar pajtueshmëri me kriteret e certifikimit dhe implementimit, dhe mirëmbajtjen e SMS-it dhe Manualit të Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit.

6.1.3 Menaxheri Përgjegjës duhet të ketë:

- 1) kontroll të plotë të burimeve njerëzore që kërkohen për të kryer operimet e autorizuara nën Certifikatën e Aerodromit
- 2) kontroll të plotë të burimeve financiare që kërkohen për të kryer operimet e autorizuara nën Certifikatën e Aerodromit
- 3) autoritetin përfundimtar për operimet e autorizuara që duhet të kryhen nën Certifikatën e Aerodromit
- 4) përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për zhvillimin e çështjeve të organizatës dhe
- 5) përgjegjësinë e përfundimtar për të gjitha çështjet e sigurisë.

6.2 Menaxheri për Siguri

6.2.1 Operatori i Aerodromit duhet të identifikojë një Menaxher për Siguri që të jetë anëtar i udhëheqësisë i cili duhet të jetë përgjegjës i vetëm dhe pikë qendrore për zbatim dhe mirëmbajtje efektive të SMS-it.

6.2.2 Menaxheri për Siguri duhet të:

- 1) garantojë që proceset e nevojshme për SMS janë krijuar, zbatuar dhe mirëmbajtur

- 2) raportojë tek Menaxheri Përgjegjës për performansën e SMS-it dhe për çfarëdo nevojë për përmirësim dhe
- 3) garantojë promovim të sigurisë në të gjithë organizatën.

6.3 Menaxheri për Operim

6.3.1 Operatori i Aerodromit duhet të identifikojë një Menaxher për Operim i cili person duhet të jetë përgjegjës për operimet e përditshme në përputhshmëri me Aneksin 14 të ONAC-it, me Manualin e Shërbimeve dhe Operimeve të Aerodromit, dhe me Rregulloren Nr. 1/2008 për Aerodromet.

6.3.2 Menaxheri për Operime duhet të:

- 1) sigurojë që operacionet dhe mirëmbajtja e Aerodromit janë në përputhje me Certifikimin e Aerodromit dhe legjislacionin në fuqi
- 2) raportojë tek Menaxheri Përgjegjës

6.4 Pozicionet tjera lidhur me sigurinë

6.4.1 Operatori i Aerodromit duhet të krijojë strukturën e nevojshme të sigurisë për zbatim dhe mirëmbajtje të organizimit të SMS-it.

6.4.2 Operatori i Aerodromit duhet të identifikojë përgjegjësitë e sigurisë për të gjithë anëtarët e lartë të udhëheqësisë, pavarësisht nga përgjegjësitë tjera.

6.4.3 Pozitat, përgjegjësitë, dhe autoritetet që kanë lidhje me sigurinë duhet të përcaktohen , dokumentohen dhe komunikohen nëpër të gjithë organizatën.